



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit

KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR 26 09 2023			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-09263-	48275		



Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e komunës për vitin 2024

Shtator, 2023

Hyrje

Buxheti i Komunës së Drenasit për vitin 2024 është 20,968,992 euro. Komuna vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme (2023-2025) do të përbëjnë afërsisht **92.56%** të buxhetit total të komunës, edhe pse në vitet paraprake pjesëmarrja e granteve në buxhet ka qenë përafërsisht **92.31%**. Të Hyrat Vetanake mesatarisht planifikohet të marrin pjesë në buxhet me **7.44%**, prej tyre të hyrat tatimore me **60.08%**; ndërsa ato jo tatimore marrin pjesë më **39.92%**. Vlen të ceket se kufijtë e të hyrave sipas burimeve të financimit të buxhetit komunal janë caktuar me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026, lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Maj/2023. Planifikimi i buxhetit komunal ndër vite pritet të ketë një rritje mesatare prej **5.46%**.

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe nenit 6 pika 1.3 Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Qarkores 01/23 dhe Qarkores 02/23 të Ministrisë së Financave, Grupi Punës në koordinim me kryetarin e Komunës së Drenasit z.Ramiz Lladrovci si dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, kanë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2024.

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar edhe në nenin 9 pika 2 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takimin direkt të mbajtur në lokalitet).

Me qëllim të informimit të qytetarëve për mundësit buxhetore dhe planifikimet paraprake të ndarjeve buxhetore në projekt buxhetin e komunës për vitin 2024, Grupi Punës në koordinim me drejtorin për buxhet dhe financa ka përgatitur një dokument të veçantë me informata të përgjithshme për projekt buxhetin e vitit 2024 duke përfshirë edhe ndarjet fillestare buxhetore të planifikuara. Ky dokument është shpërndarë në kopje fizike për të pranishmit-pjesëmarrës në dëgjimet buxhetore.

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2024

Shyqiri Bublaku – Kryesues, Milaim Hajdari - KK-Drenas (Anëtar), Avdyli Mziu - ZK (Anëtar), Kushtrim Bajraktari - ZKF (Anëtar), Lumniye Krapin - DSHPE (Anëtare), Anita Avdullahu- DBPZH (Anëtare), Petrit Gashi-DPUMM (Anëtar), Agnesë Kastrati Bucolli- DZHE (Anëtare), Laureta Thaqi- DAP (Anëtare), Enkela Dema-DKRS (Anëtare), Muhamet Gjoka - DKA (Anëtar), Endrit Gllareva- DIL (Anëtar), Enver Hoxha- DBF (Anëtar), Bekim Dobra- ZK (Anëtar), Lumturije Kiqina- DSHMS (Anëtar).

Procesi i hartimit të projekt buxhetit të vitit 2024 i ka paraprirë miratimi i Koniozës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026. Grupi Punës në bashkëpunim me ekzekutivin e komunës si dhe Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF) kanë organizuar 8 dëgjime buxhetore në bashkësitë lokale të Komunës së Drenasit. Para miratimit të këtij dokumenti strategjik nga ana e Kuvendit të Komunës, ka organizuar një dëgjim buxhetor me qytetarë. Procesverbali nga organizimi i dëgjimit buxhetor, në pajtim me kërkesave ligjore është publikuar në web faqen e komunës.

Në suaza të ecurisë dhe planifikimit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues ka hartuar Planin e Brendshëm të Veprimit të organizmit të dëgjimeve buxhetore 2024, ku janë specifikuar obligimet ndërinstitucional me qëllim të organizmit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetorë. Në këtë kontekst, është përpiluar edhe kalendari për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, ku si i tillë është përcjellë edhe me ftesat publike dhe informimi në kohë për ndryshimet që kanë ndodhur gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore. Ftesat dhe informatat për organizimin e dëgjimeve buxhetore janë publikuar në ueb faqen e komunës si dhe në mekanizma tjerë alternativ të tilla si: platformën e konsultimeve publike të nivelit qendror si dhe rrjetin social facebook :

<https://www.facebook.com/komunadrenas/posts/pfbid02WBYR9v7HFTdjtAiZpht4hWwtM8Dr8P3wiRLuATnxokWqnFAkAJkkuykXkz2c3R2Zl>

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/category/degjime-buxhetore/?fbclid=IwAR3fySDRz92SBJN4CRDPLrM9qvQssNjAqUmBBDf8Wjqkb-6aJYLCpkOpLs8>

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php>

Krahas planifikimit të dëgjimeve buxhetore me prezencë fizike, komuna e Drenasit ka synuar që projekt buxheti i vitit 2024 të jetë në konsultim edhe përmes formave elektronike, duke dhënë mundësi qytetarëve të kenë qasje në këto dokumente. Për më tepër, Qarkorja Buxhetore 01 dhe Qarkorja Buxhetore 02, janë publikuar në ueb faqen e komunës si dhe në platformën e konsultimeve në nivel qendror.

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/09/Buxheti-i-Komunes-per-vitin-2024-dhe-Parashikimi-i-buxhetiti-2025-2026.pdf>

Grupi punues, në kuadër të ndarjes së përgjegjësi dhe ndërmarrjes së aktiviteteve për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e konsultimit publik për projekt buxhetin e komunës, kishte planifikuar shfytëzimin e databazës së konsultimeve publike për të targetuar grupe të ndryshme qytetare dhe përfshirjen së tyre në proces të konsultimeve publike. Në këtë kontekst, grupi punues përmes Zyrës për Informim, përmes komunikimeve elektronike ka dërguar mbi 1000 ftesa të personalizuar për grupe të ndryshme qytetare përfshirë: OJQ, biznese, fermerët, ekzpert të fushave të ndryshme, drejtor të shkollave, përfaqësues të organizatave rinore, organizatave studentore, anëtarëve të KKSB-së, anëtarëve të kuvendit të komunës etj.

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Ndarja gjinore
Dëgjimi publik me grupe të nën përfaqësuar (gra, të rinj, student, pensionistë, personat me aftësi të kufizuara, etj.), Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës	16.08.2022, 1 orë	52 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	18 M 32 F
Dëgjimi publik me grupet e interesit (biznese, fermerët, OJQ-të, shoqëri civile, klubet sportive, klubet artistike, etj.), Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.	16.08.2023 1 orë	47 pjesëmarrës	1 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesë.	24 M 23 F
Dëgjimi publik në Arllat (Arllat, Gjergjicë, Negroc, Llapushnik, Bytyq dhe Vuçak), për buxhetin e vitit 2024. Objekti i shkollës fillore në Arllat.	18.08.2023 1 Orë e 30 minuta	31 pjesëmarrës	8 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesë.	26 M 05 F
Dëgjimi publik në Baicë (Baicë, Tërdec, Abri, Damanek dhe Krajkovë), për buxhetin e vitit 2024, Objekti i shkollës fillore në Baicë.	17.08.2023 1 Orë	26 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesë.	17 M 09 F
Dëgjimin publik në Dobroshec (Dobroshec, Godanc, Gllanasellë, Likoshan, Çikëtove e Vjetës dhe Gradicë), për buxhetin e vitit 2024. Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.	17.08.2023 1 Orë e 30 minuta	32 pjesëmarrës	7 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesë.	25 M 07 F
Dëgjimi buxhetor në Drenas (Drenas I, II dhe III, Shtrubullojë, Gllobar, Vasilevë,	18.08.2023 1 Orë	35 pjesëmarrës	6 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesë.	22 M 13 F

Poklek i Ri dhe i Vjetër), për buxhetin e vitit 2024. Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.				
Dëgjimi publik në Komoran (Komoran I, II, III, dhe IV, Zabel i Ulët dhe i Epërm, Korroticë e Ulët dhe e Epërme, Fushticë e Ulët dhe e Epërme, Sankoc, Nekoc dhe Kishnarekë),	18.08.2023 1 Orë e 15 minuta	34 pjesëmarrës	9 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesë.	26 M 08 F
Dëgjimi publik në Tërstenik (Tërsteniku I dhe II, Shtuticë, Polluzhë dhe Vëboc, Objekti i shkollës fillore në Tërstenik	17.08.2023 1 Orë e 15 minuta	29 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesë.	21 M 08 F

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Projekt buxheti i vitit 2024, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe deri më 22 shtator 2023 do të procedohet për në kuvendin e Komunës së Drenasit.

Shtojca – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Temat e dëgjimit buxhetor	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2023	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Projekt buxhet i i vitit 2024	Kërkesë për krijimin e një hapësire për komunitetin e të shurdhërve, që ky komunitet të ketë mundësi të kryejë aktivitetet tona në një vend adekuat. Gjithashtu ky vend adekuat do të na motivonte të rrisim angazhimin e gruas.	Hana Nuhija, Kryetare e komunitetit të shurdhërve në Drenas	Nuk është pranuar	Ishte pjesë e projektit tek Komuna e vjetër por që ky projekt dështoi pasi nuk kishte gatishmëri nga Kuvendi Komunal të realizohej projekti në fjalë. Ai projekt parashihnte zyre dhe hapësira të mjaftueshme për të gjithë përfaqësuesit e grupeve të marginalizuara në Komunën e Drenasit. Do të shohim në të ardhmen sesi mund të zgjidhim këtë problem.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Anëtarët e shoqatës sonë janë përfituese të shumë grandëve, kanë hapur biznese për pastiqeri dhe për gastronomi. I përshëndes ato gratë dhe njëherësh kërkojë takime më të mëdha me asamblastët të cilët nganjëherë nuk po votojnë ligje që janë në interes tonin dhe të qytetarëve në përgjithësi për shkak të disa inateve personale, e kjo është shumë e dëmshme për ne si qytetarë të Drenasit.	Kadire Tahiraj, Drejtoreshë e Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave, dega në Drenas		Përgjegjësia publike sidomos në rastet e veçanta që ndërlidhen me grupet e marginalizuara duhet të jetë më e madhe tek të zgjedhurit e qytetarëve. Ata duhet të mbështesin kërkesat e nevojshme për shoqatat e grave, grupet e marginalizuara por edhe për qytetarët tanë në përgjithësi që janë në interes të përgjithshëm.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Më herët kam aplikuar për një projekt por që ka qenë e paraparë të jetë në funksion ajo OJQ më shumë se një vit.	Rina Gashi – Drejtoreshë e OJQ-së “Liderët e së Ardhmes”		Kriteret e tilla janë të analizuara mirë nga ekspertët e fushës. Ata kanë vlerësuar që fondet të shkojnë tek OJQ-të të cilat kanë konsistencë në fushë veprimtarinë e tyre dhe të pamundësohen keqpërdorimet e mundshme nga persona të cilët hapin OJQ veç sa për të fituar projektin dhe më pas ata

				pasivizojnë aktivitetet e tyre. Konsitenca juaj bënë që vitin e ardhshëm ju të keni mundësi të aplikoni për financimin e projekteve.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Asfaltimi i rrugës Burim Gashi që frekuentohet shumë, ndriçimi i rrugës Mentor Gashi, Rrahman Gashi dhe Milazim Gashi.	Urim Gashi, përfaqësues i lagjes Tahiraj	Pjesërisht pranohet	Ndriçimi i rrugës është në proces, ai proces mund të merr kohë sepse është duke u zbatuar vetëm që nuk mund të zbatohet në tërë territorin e komunës sonë përnjëherë. Asfaltimi i rrugës do të jetë i mundshëm duke vlerësuar mundësitë buxhetore. Asnjë rrugë nuk do të mbetet pa asfaltuar por që disa prej tyre duhet më shumë kohë.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Përse ka stagnuar rruga që lidhë me rrugën Sami Gashi, dhe a merren parasysh kërkesat që parashtrohen përmes administratorit.	Xhavit Bujupi, përfaqësues i lagjes së Kodralive	Pranohet	Drejtoria e Infrastrukturës Publike do të investoi në projektin e rrugës 'Pika Prita' në fazën e dytë të punimeve e cila lidhet me rrugën "Sami Gashi" , gjithsesi të gjitha kërkesat të cilat paraqiten në DIP merren parasysh dhe shqyrton në bazë të rëndësisë.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Kyçja tek vëllezërit Gashi është e rrezikshme për fëmijët dhe për të gjithë kalimtarët e rastit.	Bashkim Thaçi, përfaqësues i lagjes Poterk	Nuk pranohet	Rruga magjistrale është nën menaxhimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe së bashku më ta do të shqyrtojmë mundësinë e zgjidhjes së këtij problemi.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Ndriçimi publik tek lagja Foniqi është keq. Puna e bërllokut aspak e mirë, si dhe me ujëra të zeza kemi problem.	Blerim Gashi, lagja Foniqi	Pjesërisht pranohet	Në ndriçim publik duhet të specifikohet se çka është keq, se aty janë dy opsione ose është funksional ose nuk është, kanalizimin i ujërave të zeza do të rregullohet brenda vitit 2024.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Kërkesat që i kemi janë kyçja në Llapushnik, një trotuar që kemi rreth autostradës sepse kemi nevojë , dalja në drejtim të Arllatit është shumë keq, si dhe kontesti qe tash e 5 vite tek nënkalimi. Një kanalizim tek Vojvodët, Nuhi Sopi për 50	Ramadan Gashi, përfaqësues Llapushnikut	Pjesërisht pranohet	Të gjitha kërkesat janë marrur në shqyrtim, dhe pas miratimit të buxhetit do të filloi hartimi i para masave dhe në bazë të mjeteve të planifikuara për këtë zonë brenda

	metra me u kyç tek Sopët, rruga Zeqir Bajrami me Rugën Beteja Llapushnikut ka mbetur 50 metra me u lidhë me u bë unaza për punët bujqësore, Zeqir Bajrami me u lidhë me Arllat.			viti 2024/2025 do të realizohen këto projekte.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Kërkesa e gjithë qytetarëve të Negrocit është rruga ,e di që është e kushtueshme por është tejet e nevojshme për neve. Për 10 metra kanalizimi ka mbetur pa u lidhë qe disa vite. Katër kërkesa për shtrimin e rrugëve me zhavorr. Një kërkesë prej një lagje komplet kanalizimi është përfunduar por kanë mbetur edhe 60 metra sepse kanë bërë pengesë Bajram Krasniqi, por jemi marrë vesh me djalin e tij që të vazhdohet edhe për ato 60 metra.	Gani Krasniqi, fshati Negroc	Pjesërisht pranohet	Komuna e Drenasit ka iniciuar kërkesën për rehabilitimin e kësaj rruge në MMPHI-ës, rregullimi i këtij segmenti rrugor ka një kosto të papërbalueshme për komunën. Kërkesat për kanalizim i ka të aprovuara dhe gjatë zhvillimit të punimeve së shpejti do të përfundojnë.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Çështja e ujit dhe çështja e dritave, ujë ka të bollshëm është vetëm lëshimi i tij, por nuk e di përse nuk po lëshohet. Kemi nevojë edhe për ndriçim.	Dardan Morina, banor i fshatit Gjergjicë	Pjesërisht pranohet	Sa i përket ujësjellësit do të diskutohet me kompaninë KRU-Prishtina, dega në Drenas për furnizim me ujë të pijes për fshatin e juaj sepse komuna ka përfunduar investimet në projektin e ujësjellësit. Ndriçimi publik do të zhvillohet brenda viti 2024 në këtë fshat.
Projekt buxhet i i vitit 2024	kisha dashur të vendoseshin 3 shkronja UÇK në kodër.	Urim Gashi Banor i fshatit Llapushnik		Është kompetencë e Agjencisë për Menaxhimin e Memorialeve, kërkesa duhet të bëhet tek ta.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Shtatë shtëpi janë pa rrugë. I kemi grumbulluar mbi 120 nënshkrime për kërkesën tone qe te kemi dalje tek tuneli, po pronari i asaj prone e ka bllokuar, lus, te behet ndonjë zgjidhje. Ndriçim në lagjen Zariqi.	Mehmet Zariqi, banor i lagjes Zariqi, Baicë	Pjesërisht pranohet	Komuna e Drenasit është duke zhvilluar bisedimet me Infrakos për një zgjidhje të këtij problemi. Ndriçimi publik do të përfundojë brenda viti 2024.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Kërkesë për asfaltimin e rrugës “Elmi Lestrani”.	Lah Kiçina, banor i fshatit Baicë	Pranohet	Me projektin e viti 2023/2024 është paraparë edhe asfaltimi i këtij segmenti rrugor pjesa e cila është pronë publike.

Projekt buxhet i i vitit 2024	Kërkesë për një fushë sportive në Tërdevc, mundësisht tek xhamia.	Ramadan Ramaj, banor i fshatit Tërdevc	Nuk pranohet	Fusha sportive aty ku ka në shkolla nuk do të ndërtojmë pasi që ne kemi marrë vendim të fushat sportive që janë nëpër shkolla të shfrytëzohen nga qytetarët pa asnjë problem. Krijimi i fushave të reja ka kosto të re edhe të mirëmbajtjes prandaj aty ku ka fusha sportive në shkolla të shfrytëzohen pa asnjë problem nga qytetarët.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Mundësisht të vendosen shtyllat elektrike prej betoni në lagjen Behrami.	Arben Haziri administrator i fshatrave Krajkovë dhe Damanek	Pjesërisht pranohet	Në ndriçim publik do të vendosen shtyllat aty ku është e nevojshme gjatë realizimit të projektit.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Rruga tek lagja e Carakëve, është prioritet i yni, por për shkak të pronësisë private, rasti është në gjykatë. Ne kemi një alternativë tjetër për shtrimin e rrugës karshi asaj rruge, por së pari të presim epilogun e procesit gjyqësor. Lagja e Gjokëve ka mbetur paksa anash, ku përveç asfaltimit të rrugës e cila është publike me gjatësi prej 70 metra, edhe shtëpitë e tyre me oborre po vërshohen nga uji. Rruga “Kamer Maloku” si dhe një rrugë nga lagja Kastrati deri tek ura e vjetër me një gjatësi prej 350 metra. Dy dëmtime të kanalizimeve janë tek lagja Avdyli, aty ku janë vendosur shtyllat elektrike. Tek fshati Çikatovë, asfaltimi i rrugës në lagjen Morina dhe Bullaku. Të bëhet ndriçimi si dhe është mbyllur kanalizimi.	Xhevdet Shihani, administrator i fshatit Dobroshec	Pjesërisht pranohet	Duhet të pritët epilogu nga procesi gjyqësor që është duke ndodhur në rastin në fjalë, mëpastaj varësisht prej atyre vendimeve të gjejmë zgjidhjen e duhur për banorët e asaj zone. Aty ku ka pronë publike do të asfaltohen rrugët, por investime nuk bëhen në pronat private sepse është e jashtëligjshme Sa i përket rrjeti të ujërave të zeza aty ku ka dëmtime nga operator të ndryshëm ju lutem drejtohuni drejtorisë së Inspektionit.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Tek ura në lagjen shala, për shkak të vërshimeve mundësisht të ndërmerret diçka.	Emin Morina banor i Çikatovës së Vjetër	Pjesërisht pranohet	Drejtoria e Infrastrukturës Publike në kohën e investimeve në këtë projekt ka pasur probleme pronësore me banoret e zonës.
Projekt buxhet	Ndriçimi ende nuk ka përfunduar. Asfaltimi i rrugës Adem Berbatovci, ma konkretisht tek Mehd Fazliu në Godanc,	Qerim Berbatovci, Administrato	Pjesërisht pranohet	Ndriçimi është në proces sikurse që jemi përgjigjur tek kërkuesit e mëhershëm, ndërsa rruga është e

i i vitit 2024	kjo rrugë po shembet. Vendorsja e anësorëve në rrugën Milazim Fazliu. Urën që e ka ndërtuar KFOR-i është shumë e ngushtë. Si dhe, një fushë sporti.	ri i fshatit Godanc		parapame në projektin i cili ka ankesa ne OSHP, sa i përket urës do analizohet situata nga inxhinierët e drejtorisë dhe do të investohet. Fushë sporti nuk ndërtojmë aty ku ka fusha në shkolla, ritheksojmë të shfrytëzoni fushat sportive në shkolla. Vendorsja e anësorëve mund të realizohet nëse shohim që ka pronë publike në atë zonë.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Rruga në lagjen Avdyli të asfaltohet, jemi në proces të kthimit në pronë publike. Më herët ishte e shtruar me kalldrëm, por kur me vendosjen e shtyllave elektrike është dëmtuar shume madje as me traktor nuk kalohet në atë rrugë.	Miftar Avdyli, banor i lagjës Avdyli	Pranohet	Rrugët janë në proces të ndërtimit.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Kanalizimi i cili vjen nga fshati Gllanasellë, mundësisht të riparohet, pasi që i njëjti është dëmtuar dhe bllokuar nga vërshimet. Si dhe, rregullimi i shkollës, në veçanti, renovimin e dritareve pasi që ato janë të dëmtuara.	Arsim Avdyli, Drejtor i shkollës	Pranohet	Do merren masat e nevojshme për sanimin e problemeve me rrjetin e kanalizimeve. Kanalizimi i ujërave të zeza do të rregullohet brenda vitit 2023/2024. Kjo shkollë është rinovuar disa herë, aty ku ka nevojë do të rinovohet përsëri.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Rruga karshi varrezave të lagjes Nika, që lidhë fshatrat Gllanasellë-Gllobar, të rregullohet; Rruga nga lagja Berisha deri tek lagja Nika, edhe ajo mundësisht të rregullohet; Si dhe të ndërtohet trotuari nga shkolla.	Eshref Nika, administrator i fshatit Gllanasellë	Pjesërisht pranohet	Për segmentin rrugor Gllanasellë – Godanc do të hartohet projekti brenda viti 2024. Në projektin e trotuarit aty ku ekziston hapësira publike do të investohet. Rruga që lidhë lagjen Berisha deri te lagjja Nika do të shqyrtohet ne bazë te mjeteve buxhetore
Projekt buxhet i i vitit 2024	Nxënësin nga lagja Shehu, në Dobroshec, nëse ka mundësi ta dërgoni për shërim diku pasi që i njëjti ka sjellje shumë agresive, si dhe nxënësit tjerë po vuajnë nga ai.	Behram Maloku, banor i lagjës Maloku		Është kompetencë e institucioneve tjera të cilat duhet të merren me rastin. Ju bëjmë thirrje që të bëni kërkesën tek organet gjegjëse.

Projekt buxhet i i vitit 2024	Sanimi i problemit të kanalizimit (zhbllokimi), në lagjen Elshani, fshati Gllobar. Kyçja e 7 shtëpive në kanalizimin publik, të cilat deri me tani nuk janë kyçur asnjëherë. Si dhe asfaltimi i tre rrugëve, të cilat kanë mbetur ende pa u shtruar.	Murat Elshani, Administrator i fshatit Gllobar	Pranohet	Kanalizimi i ujërve të zeza është në procesin e punimeve. Asfaltimi i rrugëve do të përfundojë brenda periudhës 2024/2025.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Kanalizimi tek lagja Hasi, në rrugën Ramadan Dudi, tash e katër vite derdhët në rrugë. Kemi parashtruar mbi 7 kërkesa që janë bërë me shkrim, por nuk janë realizuar. Kërkesë për ndriçim në lagje. Si dhe të investohet në lagje, pasi që kemi vetë një rrugë të shtruar me kocka dhe asgjë me tepër.	Akil Rruqi, banor i Drenasi I	Pranohet	Kërkesat nga Drenasi I janë në prioritetet e Komunës së Drenasit dhe projektet në fjalë do të realizohen.
Projekt buxhet i i vitit 2024	80 mijë euro janë të zotuar për vitin 2024 për Gllobar, Tërstenik 1 dhe 2. Sa do të jetë shuma vetëm për fshatin Gllobar. Kërkesë për asfaltim të rrugës në lagjen Tërdevci në Gllobar, si dhe ndriçimi publik sepse ka shtylla të betonit në atë pjesë.	Egzona Tërdevci, asambliste e Kuvendit Komunal	Pjesërisht pranohet	Drejtoria e Infrastrukturës Publike në fshatin Gllobar ka përfunduar një pjesë të madhe të infrastrukturës duke përfshirë asfaltim, kanalizim, ndriçimin publik, trotuar por do të investohet në segmentet e mbetura.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Tre rrugë kanë mbetur ende të pa asfaltuara. Një rrugë, e cila do të përfshinte tri lagjet, të shtrohet, pasi që ato lagje kanë vetëm rrugica që lidhen me rrugë kryesore; Si dhe ta kemi një fushë sporti.	Hajrush Musliu, administrator i fshatit Shtrubullovë	Pranohet	Drejtoria e Infrastrukturës Publike në projektin 2023/2024 ka paraparë investimin dhe përfundimin në këto segmente rrugore.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Kemi nevojë për një vigë (urë këmbësorësh) mbi lumin Drenica, që shpie për tek fshati Poklek Vjetër. Ndriçim në fshatin Vasilevë. Rruga e cila lidhë Poklekun me Vasilevë ende nuk është shtruar. Tek uji i gazuar, të investohet diçka pasi që po kemi shumë vizitorë në atë vend.	Zekë Kluna: Administrator i fshatrave Poklek i Ri dhe i Vjetër si dhe Vasilevë:	Pjesërisht pranohet	Sa i përket projekti të vigut administratori është i njoftuar për arsyen e mos realizimit të tij. Të gjitha rrugët të cilat kanë më pak prioritet do të investohen në një periudhë tjetër.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Të sanohet ura, pasi që është në gjendje të mjerueshme, si dhe karshi rrugës nga rrethi e deri tek ura të ketë dhe një trotuar.	Nexhmedin Hyseni, banor i Drenasit I	Pranohet	Drejtoria e Infrastrukturës Publike brenda periudhës 2024/2025 do investojë në këtë projekt.
Projekt buxhet	Kërkesat e mia si administrator i këtyre fshatrave janë si vijon: Sankoc: 1300	Kadri Ajazi, Administrator	Pjesërisht pranohet	Në bazë të mjeteve buxhetore për këtë zonë do shiqohet mundësia e

i i vitit 2024	metra rrugica për asfaltim, dy kolektorë, të vazhdohet me ndriçimin e fshatit, trotuari, asfaltimi i rrugës Sankoc-Mirenë, rruga për Krivovë (tek parku i biznesit). Fushticë e Epërme: Ndriçimi, trotuari, kanalizimi (depërtimi i kanalizimit në një rrugë), vazhdimi i meremetimit të shkollës, si dhe asfaltimi i rrugës “Amrush Ferizi”. Fushticë e Ulët: Asfaltimi i rrugës UÇK, Osman Bahtari, si dhe kanalizimi.	r për fshatrat Sankoc, Fushticë e Epërme dhe e Ulët		investimeve dhe realizimi i kërkesave. Kanalizimi i ujërave të zeza do të përfundoj brenda viti 2023/2024.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Rregullimi i Zyrës së Gjendjes Civile në Komoran; Rregullimi i stacionit të policisë dhe njësive të zjarrfikësve; Rregullimi i parkut “Pishat e Komoranit”; Asfaltimi i rreth 800 metrave rrugica në lagjet Bashota, Nishori, Cakaj; Vendosja e 650 metrave kanalizim në rrugën “Xheladin Gashi”; Instalimi i ndriçimit në rrugët “Avdullah Cakaj”, “Bajram Cakaj”, “Xheladin Gashi”, “Fazli Grajqevci” dhe “Skender Mulaku”; Shtruarjen e trotuarit me kube në rrugën “Mentor Ibriqi”; Funksionalizimin dhe zgjerimin e kamerave në qendrën e Komoranit; Vendosja e vend ndaljeve për autobus në Komoran -I- dhe - II-; Puna e laboratorit në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Komoran gjatë ditëve të vikendit; Emërtimi i rrugëve sipas kërkesave të qytetarëve.	Besim Nishori, Administratori i Komoranit 1 dhe 2	Pjesërisht pranohet	Po jemi në dijeni për problemin që është në Zyrën e Gjendjes Civile në Komoran, aty Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emërgjencë sipas mundësive buxhetore do të investojë të sanojë problemet me mykun. Pishat në Komoran është projekt të cilin e kemi dorëzuar edhe tek Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe presim që projekti të realizohet në vitin 2024. Të gjitha investimet kapitale do të realizohen sipas mundësive buxhetore aty ku i shohim si më prioritare. Ritheksojmë se për të njëjtat duhet të jenë në pronat publike. Emërtimi i rrugëve është në kompetencë të komisionit përkatës.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Përveç asfaltimit të rrugëve ne kemi nevojë edhe për trotuare. Është një kanal i hapur prej xhamisë që shkon në drejtim të lagjes Bajraktari dhe kthehet tek lagja Berisha. Ato familje shumë herë i dëmton, e kam bërë një kërkesë për të zgjidhur këtë problem. Ndriçimin në shumicën e vendit	Imri Bajraktari, Administratori i fshatit Kishnarekë	Pranohet	Për kanalin e hapur do shiqohet mundësia e investimit brenda viti 2024/2025, ndriçimi do të fillojë brenda viti 2024.

	e kemi bënë me mjete tona vetanake, por i kemi dy lagje që kemi nevojë për ndriçim.			
Projekt buxhet i vitit 2024	I kemi diku 2 mijë metra asfaltim të rrugëve. Kanalizim nuk kemi, kemi problem me ujëra të zeza. Ndriçimi publik nuk kanë shkuar absolut me radhë lagjen me radhë. Kërkesa për varreza sepse nuk kemi varreza.	Blerim Sinani, Administrator i fshatit Korroticë e Poshtme dhe Zabeli Ulët	Pranohet	Të gjitha investimet do të realizohen në bazë të mjeteve buxhetore për zonën e juaj.
Projekt buxhet i vitit 2024	Ndriçimi publik në prona publike, për rrugë.	Dardan Bogiqi, përfaqësues i Komoranit 4	Pranohet	Projekti i ndriçimit publik do të fillojë brenda viti 2024.
Projekt buxhet i vitit 2024	Në Korroticë të Lartë, në disa lagje mungon kanalizimi, e disa tjera nuk janë të kyçura askund, si p.sh lagja Pecani. Kemi rrugë të paasfaltuara, sidomos tek Kroi i Mbretit është në gjendje të mjerueshme. Ndriçimi tek lagja Dobërdalani mungon.	Xhafer Doberdolani, përfaqësues për Korroticë të Lartë dhe për Zabel të Lartë	Pjesërisht pranohet	Rrjeti i kanalizimit të ujërave të zeza do të përfundojë brenda viti 2024 ndërsa sa i përket projekti të rrugëve në bazë të mjeteve buxhetore do të investohet. Ndriçimi publik do të përfundojë brenda viti 2024.
Projekt buxhet i vitit 2024	Në rrugën Imer Alushani, trotuari ka mbetur pa u përfunduar. Po ashtu, ndriçimi në këtë rrugë mungon edhe pse kemi shtylla elektrike të betonit. Problemi kryesor është kanalizimi, ku ujerat e zeza i kemi mbi sipërfaqe. Asfalti është prerë dhe ka mbetur ashtu, d.m.th nuk është rregulluar nga kompania. Ujësijellësi është i dëmtuar nga kompania pune kryerëse dhe kemi 52 familje ende pa ujësijellës. 1.Trotuari i mbetur në Rrugën "Skender Mulaku" dhe Rrugën "Imer Alushani" 2.Ndriçimi i mbetur në Komoranin III 3.Riparimi i rrugëve "Skender Mulaku" & "Imer Alushani" 4.Derperimi në Rrugën "Imer Alushani" për lidhjen e ujërave të zeza të lagjeve Mulaku, Nishori, Alushani, Berisha, Obria. 5.Fusha e sportit e premtuar në lagje Mulaku, Nishori.	Sali Berisha, Komorani 3	Pjesërisht pranohet	Në projektin 2023 dhe 2024 jemi në investime të ujësijellësit në të gjitha fshatrat, shpresojmë që të përfundojë dhe të funksionalizohen shumë segmente të cilat furnizojnë fshatrat me ujë të pijes. Projektet tjera do të realizohen sipas mundësive buxhetore dhe do të vlerësohen në bazë të prioriteteve.

	6.Rregullimi i Gypit të ujëllësit për lagjen Alushani, Berisha, Obria i dëmtuar nga operatorët e komunës dhe është jashtë funksionit. 7.Asfaltimi i rrugës “Milazim Nishori” 200 m 8.Asfaltimi në lagjën Vilaku 300 metra baza u përfundu qe dy vite 9.Thurja e varrezave lagje Mulaku, Gashi, Nishori. 10.Kanalizime në pjesë të ndryshme të fshatit mbi 1000 metra. 11.Vendosja e emërtimeve të rrugëve. 12.Në rrugë të vendosen pasqyre pasi që ka rrezik në dukje. Rruga “Imer Alushani”, “Skender Mulaku”.			
Projekt buxhet i i vitit 2024	Të përfundoj ndriçimi. I kemi 8 familje që kanë mbetur pa kanalizim.	Izet Bytyqi, përfaqësues i fshatit Fushticë e Epërme	Pranohet	Kanalizimi i ujërave të zeza do të përfundojnë brenda viti 2024.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Kërkesë e veçantë për trotuar. I kemi afër 800 metra hapësirë për trotuar por nuk kemi pronë publike. Fshati Zabel i Epërm ka mbi 1 km shtrirje, po kanalizim i kemi vetëm 800 metra. Nëse ka mundësi të bëhet një trase, e cila lidhet me fshatin Sankoc.	Fahredin Hajdini – përfaqësues i fshatit Zabel i Epërm	Nuk pranohet	Aty ku egziston prona publike do të investohet me infrastrukturë ndërsa për prona private komuna nuk ka mundësi buxhetore të shpronësimit.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Kërkesa për ndriçim në lagjen Dvorani. Kemi problem me ujë. Kemi nevojë për disa asfaltime të rrugëve të degëzuara nga 50 metra përafërsisht. Lagja Kacurreti e Hoti, një pjesë e tyre është asfaltuar, por ka mbetur edhe pak.	Agim Kacurreti, përfaqësues i fshatit Tërstenik	Pranohet	Në projektin 2023 dhe 2024 jemi në investime të ujësjellësit në të gjitha fshatrat, shpresojmë që të përfundoj dhe të funksionalizohen shumë segmente të cilat furnizojnë fshatrat me ujë të pijes. Ndriçimi do të vazhdoj brenda viti 2024, ndërsa asfaltimi i rrugëve do të vazhdojë në bazë të mjete buxhetore për zonën.
Projekt buxhet	Kërkesat tona janë disa rrugë, lagjen Istogu edhe lagjen Kastrati, është në pronë	Arbnor Istogu,	Pranohet	Brenda viti 2024 do të investohet dhe përfundohen të gjitha rrugica të fshatit Polluzhë.

i i vitit 2024	publike dhe është e nevojshme edhe për fëmijët që shkojnë në shkollë.	përfaqësues i fshatit Polluzhë		
Projekt buxhet i i vitit 2024	Të bëhet një lidhje/trotuar nga hyrja emergjente deri tek fusha e sportit.	Lindihana Qorri, Drejtoreshë e shkollës fillore në Tërstenik	Pranohet	Po do realizohet, jeni në kontakt me Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Drejtorinë e Arsimit.
Projekt buxhet i i vitit 2024	Për dallim nga pjesa tjetër e Tërstenikut, ne s'kemi ujë. Kërkesën edhe me shkrim do e bëjmë sepse kemi nevojë të madhe.	Rexhep Gjoka, banor i lagjes Gjoka	Pranohet	Në projektin 2023 dhe 2024 jemi në investime të ujësjellësit në të gjitha fshatrat, shpresojmë që të përfundoj dhe të funksionalizohen shumë segmente të cilat furnizojnë fshatrat me ujë të pijes.

Drenas, 26.09.2023

Grupi Punues